

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIASPORU  
 Nr. i Prot. 333  
 Broj Prot. 333  
 Prot. No. 333  
 Nr. i Faqeve 10  
 Br. Stranica 10  
 No. Pages 10  
 Data 28.03.2014  
 Datum 28.03.2014  
 Date 28.03.2014  
 Prishtinë / a



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada – Government**

**Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora**

<b>REFERENCË:</b>	
<b>Date/Date/Datum</b>	28.3.2014
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Agim Krasniqi, drejtor i departamentit të buxhetit, MF
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Shyhrete Gosalci, u.d. Sekretare e Përgjithshme
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hamdi Bërbatovci, u.d. udhëheqës i Divizionit të Buxhetit dhe Financave
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015 - 2017



I nderuari z. Krasniqi,

Ministria e Diasporës ka punuar në procesin e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin 2015-2017 dhe i ka vlerësuar kufijtë e saj për 2015-2017, andaj po jua përcjellim këto vlerësime si më poshtë.

Me respekt,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Qeveria - Vlada – Government  
Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

---

## **KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE**

**2015 - 2017**

**Mars 2014**

**Prishtinë**

## Misioni

Ministria e Diasporës (këtu e tutje MeD) është përgjegjëse t'i krijojë, t'i zhvillojë dhe t'i mbajë lidhjet e gjithanshme institucionale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës së saj, si dhe me organizatat dhe shoqatat e tyre. Misioni i MeD-së është afrimi i diasporës me Kosovën, mbajtja e lidhjeve sa më të forta me të, mbështetja për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturor e gjuhësor, si dhe rritja e pjesëmarrjes së diasporës dhe mërgatës në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Ministria e Diasporës me programet e veta kryen veprimtari kulturore, arsimore, sportive, rinore, informuese, ekonomike, shkencore, publikuese etj., në të mirë të përmirësimit të pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës si në raport me vendin ku jeton dhe vepron, gjithashtu edhe me vendin e origjinës.

## Situata aktuale

Republika e Kosovës ka një diasporë të madhe. Supozohet se mes 800 mijë deri në 1 milion banorë ose 1/3 e popullsisë së saj jeton jashtë vendit. Sipas hulumtimit dhe analizës "Praktikat e përdorura për tërheqjen e investimeve nga diaspora", realizuar nga MeD-ja dhe nga Riinvest-i, si dhe nga burimet e Bankës Qendrore të Kosovës, del se në vitin 2012 rreth 580 milionë euro ishin remitencat vjetore nga diaspora dhe mërgata.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 03/145 të datës 26.8.2013, e ka aprovuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Diasporën dhe Mërgatën 2013 – 2018. Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën është dokumenti i parë strategjik i Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet të cilit, me veprime konkrete, synohet të sigurohen avancimi i të drejtave politike e sociale të diasporës, ruajtja e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, shmangia e asimilimit, ndihma për integrimin në vendet ku jetojnë dhe lehtësi maksimale ligjore e administrative për ata që duan ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të atdheut të tyre.

Mbështetur në dispozitat ligjore, në Ligjin e Diasporës dhe Mërgatës, si dhe në Planin Zhvillimor Strategjik, Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2013 është angazhuar për realizimin e objektivave të saj.

Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 04/L-095 të Diasporës dhe Mërgatës, si dhe nxjerrja e akteve të tjera nënligjore kanë bërë që Ministria e Diasporës të përqendrohet në prioritetet e saj, duke hartuar dhe duke zbatuar politikat e veta në promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor të pjesëtarëve të diasporës.

Këtë vit janë bërë hapa konkretë për krijimin e urave lidhëse mes pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe për krijimin dhe forcimin e lidhjeve brenda vetë diasporës, si p.sh. krijimi i Rrjetit të Grave në Biznes, Rrjetëzimi i Bizneseve të Diasporës, Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë në Mërgatë etj.

Pas hapjes së Qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën (QKKDM) në Turqi si qendër e parë, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 25.10.2013 janë themeluar edhe qendrat e tilla në Zvicër, Gjermani, Francë, Austri, Suedi dhe SHBA. QKKDM-të në Turqi dhe Zvicër janë funksionale, ndërsa të tjera priten të funksionalizohen së shpejti. Hapja e qendrave të përbashkëta ndërmjet Republikës së Kosovës